UDHËZIM
Nr. 28, datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 31, DATË 26.12.2013, "PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË OBLIGACIONEVE NË FORMË REGJISTRIMI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, "Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi", bëhet një ndryshim si më poshtë:

Neni 1

Pika 1 e nenit 9, ndryshohet si vijon :
Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në lekë është 300,000.00 (treqind mijë) lekë, ndërsa shuma minimale për pjesëmarrje në ankandet e obligacioneve në valute është 3,000.00 (tre mijë) euro/USD.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas Botimit ne Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj